



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

---

Kom.Dh.Shk.II.nr.951/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit N.T.P “Merotex”, me seli në fshatin Rufc i Ri, Komuna e Lipjanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.B., avokat nga Lipjani, kundër të paditurit “Korporata Energjetike e Kosovës – KEK” SH.A., me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson F.SH., me objekt kontesti borxh, vlera e kontestit 26,408.06 €, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.1300/2022, të datës 07.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.09.2023, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës “Korporata Energjetike e Kosovës – KEK” SH.A., me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.1300/2022, të datës 07.04.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, në piken I të dispozitivit ka vendosur që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.T.P “Merotex”, dhe të detyrohet i padituri

“Korporata Energjetike e Kosovës – KEK” SH.A., që në emër të borxhit sipas marrëveshjes jashtëgjyqësore të datës 06.09.2004, paditësit t’ia paguajë shumën prej 26,408.06 € (njëzetegjashtë mijë e katërqind e tetë euro e gjashtë cent), me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankat komerciale në periudhë kohore prej një viti pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 05.07.2006, deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si dhe të detyrohet i padituri që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 2,344.00 € (dy mijë e treqind e dyzet e katër euro), në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura “Korporata Energjetike e Kosovës – KEK” SH.A., me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Dhoma e Shkallës së Dytë ta anulojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ose ta ndryshoj duke e refuzuar të njejtën.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar pala paditëse.

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkallës së Dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK , gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se, paditësi N.T.P “Merotex”, me seli në Lipjan, pranë Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, me datë 06.06.2005 ka paraqitur propozim për ekzekutim në bazë të dokumentit të besueshëm, ndaj të paditurit “Korporata Energjetike e Kosovës – KEK” SH.A – Separacioni nga Kastrioti, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori në afat prej 8 ditësh t’i paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 26,480.06 €, me kamatë ligjore në vlerë 4%, prej datës 01.05.2002 deri në pagesën definitive, ndërsa me datë 05.07.2006, ka paraqitur padi pranë Gjykatës Supreme të Kosovës – Dhoma e Posaçme, me të njëjtën kërkesë.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktgjykimin EK.nr.213/20 të datës 23.09.2021, ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit N.T.P “Merotex”, për pagesën e borxhit sipas marrëveshjes jashtëgjyqësore të datës 06.09.2004, në shumën e përgjithshme prej 26,408.06 €, me kamatë vjetore prej 3.5% duke filluar nga data 01.09.2002 e deri më datë 31.12.2012, ndërsa nga data 01.01.2013 me kamatë ligjore në lartësi prej 8% në vit, e deri në pagesën definitive. Ndërsa në pikën II të dispozitivit është vendosur që shpenzimet e procedurës kontestimore i bartin secila palë veç e veç.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur në procedurën ankimore sipas ankesës së palës paditëse, me aktvendimin Ae.nr.282/21 të datës 14.12.2021, ka prishur aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike EK.nr.213/20 të datës 23.09.2021 dhe çështja i është kthyer të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në provat e lëndës, ka vërtetuar se palët ndërgjyqëse , paditësi dhe i padituri kanë lidhur ndërmjet tyre marrëveshje më të cilat është përcaktuar qartë detyrimi i palës së paditur, lartësia e detyrimit dhe koha e përmbushjes së tij, andaj sipas qëndrimit të kësaj gjykate marrëveshja të cilën palët e lidhin mbi çështjen kontestuese, pa marrë parasysh nëse është bërë gjatë procedurës para gjykatës (pajtimi gjyqësor) ose jashtë gjykatës (pajtimi jashtë gjyqësor), paraqet në fakt kontratë të palëve, me të cilën ato i rregullojnë raportet e tyre civilo-juridike. Kjo për faktin se në aspektin e të së drejtës procedurale, marrëveshja është akt i disponibilitetit të palëve me të cilën ato i rregullojnë të drejtat dhe obligimet e ndërsjella. Ndërsa në kuptim të së drejtës materiale marrëveshja e lidhur ndërmjet palëve ka cilësinë e kontratës sepse i përmban të gjitha elementet e kontratës duke përfshirë vullnetin e lirë për lidhjen e saj, objektin e kontratës, çmimin dhe afatin e përmbushjes së obligimit. Në rastin konkret, nga provat e administruara, rezulton i pa kontestueshëm fakti se palët kanë lidhë marrëveshje për pranimin dhe përcaktimin e lartësisë së borxhit si dhe kohës së përmbushjes së detyrimit, e cila marrëveshje nuk është kontestuar asnjëherë nga i padituri, deri në paraqitjen e rastit në gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se i ka shqyrtuar edhe pretendimet e palës së paditur e cila ka theksuar se paditësi në këtë çështje juridike ka hequr dorë nga padia dhe kërkesëpadija me anë

të parashtrës të datës 06.09.2004, andaj kjo çështje është gjykuar dhe nuk mund të hapet përsëri procedurë gjyqësore për të njëjtën çështje juridike, mirëpo ka gjetur se të njëjtat janë të pabazuara.

Po ashtu gjykata e konsideroi si të pabazuar edhe kundërshtimin e të paditurit lidhur me validitetin e ujdisë jashtëgjyqësore dhe mungesën e legjitimiteti pasiv. Sipas pretendimeve të palës së paditur ujdia jashtëgjyqësore është e lidhur nga persona jo kompetent, për faktin se Seperacioni nuk gëzon cilësinë e personit juridik dhe në qarkullimin me persona të tretë nuk mund të operojë e pavarur nga KEK-u dhe si e tillë nuk krijon obligime për të paditurit.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate një pretendim i tillë i të paditurit është në tërësi i pabazuar për faktin se mos-respektimi i procedurave nga zyrtarët e të paditurit nuk e liron atë nga detyrimi ndaj palëve të treta respektivisht ndaj paditësit, ngase detyrimi për mbikëqyrjen e respektimit të procedurave nga organet dhe zyrtarët e të paditurit është përgjegjësi e të paditurit dhe nuk bie mbi palët tjera në këtë rast paditësin.

Për më tepër gjykata vlerëson se me vetë faktin se në rastin konkret ujdia jashtëgjyqësore është e nënshkruar nga pala e paditur dhe mban vulën e të paditurit, rezulton se personit të cilit i është dhënë vula në posedim ka qenë i autorizuar për ndërmarrjen e veprimeve në emër dhe në llogari të të paditurit.

Gjykata në shkallë të parë po ashtu vlerësoi edhe pretendimet e të paditurit se kërkesa e paditësit është e parashkruar por gjeti se një pretendim i tillë i debitorit është pa mbështetje ligjore, sepse dispozita e nenit 374 të LMD-së, përcakton se kërkesat reciproke të personave shoqëror juridikë nga kontrata në qarkullimin e mallrave e të shërbimeve si dhe kërkesat e kompensimit për shpenzimet e bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tre vjet. Në rastin konkret ujdia jashtëgjyqësore është lidhur me datë 06.09.2004, ndërsa padia është paraqitur me datë 06.06.2005, nga çka rezulton se kërkesa e paditësit për pagesën e borxhit është paraqitur brenda afatit tre vjeçar.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe

m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkallës së Dytë , ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë, duke vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Aktgjykimi i goditur përmban arsye të mjaftueshme për fakte relevante të cilat i pranon edhe kjo gjykatë ankimore, ndërsa nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Janë të pabazuara thëniet në ankesën e së paditurës së aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje qenësore të dispozitës nga neni 182 par.2 pika n) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, se aktgjykimi ka mangësi, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me vetveten dhe nuk ka arsye mbi fakte vendimtare. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse kur ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit dhe vendimin e saj e mbështet në provat e administruara, të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Aktgjykimi i atakuar është i kuptueshëm përmban arsye të mjaftueshme dhe të kuptueshme për faktet vendimtare dhe nuk ekzistojnë kundërthënie mes dispozitivit të aktgjykimi dhe arsyeve të dhëna dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale pasi me nenin 262 par.1 të LMD-së, është përcaktuar se: *“kreditori në marrëdhënien detyrimore është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, kurse debitori është i detyruar që ta përmbushë detyrimin në tërësi”*. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se i padituri, duke mos e kryer detyrimin e tij që ka rrjedhur nga ujdia jashtëgjyqësore e cila gjenden në shkresat e lëndës, i ka mbetur borxh paditësit në shumën prej 26,408.06 € (njëzetegjashtë mijë e katërqind e tetë euro e gjashtë cent), me ç ‘rast ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa i padituri cilësinë e debitorit. Gjithashtu me vetë

faktin se në rastin konkret ujdia jashtëgjqësore është e nënshkruar nga pala e paditur dhe mban vulën e të paditurit, rezulton se personit të cilit i është dhënë vula në posedim ka qenë i autorizuar për ndërmarrjen e veprimeve në emër dhe në llogari të paditurit.

Dhoma e Shkallës së Dytë sa i përket pretendimeve të palës së paditur e cila ka theksuar se paditësi në këtë çështje juridike ka hequr dorë nga padia dhe kërkesëpadia me anë të parashtresës të datës 06.09.2004, andaj kjo çështje është gjykuar dhe nuk mund të hapet përsëri procedurë gjyqësore për të njëjtën çështje juridike, vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë drejt ka vendosur ku ka konstatuar se sipas aktvendimit I.C.nr.162/2004 të datës 20.09.2004, është konstatuar se padia se në këtë çështje juridike është tërhequr dhe në arsyetim është theksuar se vendimi është marrë konform nenit 193 par 1 dhe 2 të LPK-së në fuqi në kohën e vendosjes (LPK 1977) e cila dispozitë rregullon tërheqjen e padisë e jo heqjen dorë nga kërkesëpadia, gjë e cila është konstatuar edhe me aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ae.nr.96/2017 të datës 14.04.2017, me të cilin është prishur aktvendimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë II.C.nr.271/2008 të datës 24.10.2008 për hedhjen poshtë të padisë si të palejueshme.

Kolegji i Dhomës së Dytë sa i përket çështjes së parashkrimit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se ujdia jashtëgjqësore është lidhur me datë 06.09.2004, ndërsa padia është paraqitur me datë 06.06.2005, nga çka rezulton se kërkesa e paditësit për pagesën e borxhit është paraqitur brenda afatit tre vjeçar.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata Komerciale .

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së .

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS ,**  
Kom.Dh.Shk.II.nr.951/2023 dt.05.09.2023

KRYETARJA E KOLEGJIT,  
Saranda Bogaj Sheremeti